

PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE

2026-2028

BASHKIA RROGOZHINE

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore i Bashkisë Rrogozhinw përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt një qeverisjeje më të përgjegjshme dhe të ndjeshme ndaj nevojave të të gjithë qytetarëve, pa dallim gjinor. Ky dokument është fryt i një bashkëpunimi të ngushtë midis stafit të bashkisë dhe anëtarëve të Këshillit Bashkiak, duke reflektuar vullnetin politik dhe angazhimin institucional për të avancuar barazinë gjinore si pjesë integrale të zhvillimit lokal.

Përmes analizave të detajuara dhe rekomandimeve të bazuara në vlerësime profesionale, plani synon krijimin e një kuadri të qartë veprimi që do të ndihmojë në identifikimin dhe eliminimin e pengesave strukturore që pengojnë barazinë. Përgatitja e tij është një dëshmi e përkushtimit për të ndërtuar mekanizma funksionalë që mbështesin pjesëmarrjen e barabartë dhe trajtimin dinjitoz të grave dhe burrave në çdo aspekt të jetës publike dhe institucionale.

Dokumenti ka për qëllim të jetë një mjet praktik në duart e administratës vendore dhe aktorëve të tjerë lokalë, duke u shërbyer si udhërrëfyes në zbatimin e politikave gjithëpërfshirëse. Në këtë mënyrë, Bashkia Rrogozhinw jo vetëm që promovon barazinë gjinore, por gjithashtu kontribuon në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe të barabartë për të gjithë qytetarët e saj.

Janar 2026

Barazia gjinore është një nga shtyllat kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm dhe një prioritet i pandashëm i vizionit tonë për një qeverisje vendore të drejtë dhe gjithëpërfshirëse.

Në emër të Bashkisë Rrogozhinw, kam kënaqësinë të ndaj me komunitetin tonë hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore, një dokument strategjik që pasqyron angazhimin tonë të palëkundur për ndërtimin e një qeverisjeje vendore më të drejtë, të barabartë dhe

gjithëpërfshirëse. Ky plan është rezultat i një procesi të hapur dhe bashkëpunues, i cili ka përfshirë zërin dhe ekspertizën e administratës, këshillit bashkiak dhe përfaqësuesve të komunitetit tonë.

Barazia gjinore nuk është thjesht një parim, por një domosdoshmëri për zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për të gjithë qytetarët tanë. Ky plan do të na udhëheqë në ndërmarrjen e veprimeve konkrete për të forcuar pjesëmarrjen e barabartë në vendimmarrje, për të promovuar mundësi të barabarta në punësim, arsim dhe shërbime, si dhe për të luftuar çdo formë diskriminimi gjinor në nivel lokal.

Ne mbetemi të përkushtuar që ky plan të mos mbetet vetëm një dokument, por të kthehet në një instrument të fuqishëm transformimi për realitetin e përditshëm të qytetarëve tanë. Përmes bashkëpunimit të ngushtë me komunitetin dhe institucionet partnere, do të sigurojmë që çdo hap përpara në drejtim të barazisë gjinore të jetë një hap drejt një shoqërie më të drejtë dhe të bashkuar për të gjithë.

Kryetar i Bashkisë Rrogozhinw

Edison Memolla

Tabela e përmbajtjes

Deklarata e Integritetit Institucional.....	Error! Bookmark not defined.
• HYRJE	4
• QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT	5
Objektivat e Planit.....	6
• KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL	6
• METODOLOGJIA	10
• VIZIONI, FUSHAT E NDËRHJRJES DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË.....	12
Vizioni.....	12
Fushat e Ndërhjrjes	12
Objektivat Specifikë për Fushat e Ndërhjrjes.....	12
• AKTORËT E PËRFSHIRË NË HARTIMIN DHE ZBATIMIN E PLANIT	14
• PLANI FINANCIAR I ZBATIMIT TË PVVBGJ 2026–2028 –BASHKIA RROGOZHINE	18
• MATRICA E PVVBGJ 2026–2028 – BASHKIA RROGOZHINE	20
• PLANI I MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT PËR ZBATIMIN E PVVBGJ	24
1. Qëllimi i Planit të Monitorimit dhe Vlerësimit.....	24
2. Elementet Kryesore të Monitorimit.....	24
3. Metodatat e Mbledhjes së të Dhënave.....	25
4. Faza e Vlerësimit	25
5. Raportimi dhe Përdorimi i Rezultateve.....	26
• PËRFUNDIME	27
• REKOMANDIME.....	27

• HYRJE

Barazia gjinore është një nga prioritetet kryesore të qeverisjes vendore dhe përbën një kusht thelbësor për zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. Bashkia Rrogozhinw ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në këtë drejtim, duke respektuar kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar për barazinë gjinore dhe duke përfshirë masa konkrete për nxitjen e pjesëmarrjes së grave dhe burrave në jetën sociale, ekonomike dhe politike.

Ky **Plan Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2028** përbën një dokument strategjik dhe operacional që synon:

- Të përmirësojë cilësinë e jetës për gratë dhe burrat në bashki,
- Të nxisë përfaqësimin dhe fuqizimin e grave në të gjitha fushat,
- Të krijojë mekanizma të mbrojtjes për gratë dhe vajzat në situata të vështira.

Plani mbështetet mbi parimet e **Ligjit nr. 9970/2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”**, **Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore**, si dhe **Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm**, në veçanti OZHQ 5: *Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave*.

Drejtësia gjinore nënkupton që gratë dhe burrat trajtohen në mënyrë të drejtë, sipas nevojave të tyre përkatëse. Kjo mund të përfshijë trajtim të barabartë ose trajtim të ndryshëm, por të barasvlershëm për nga të drejtat, përfitimet, detyrimet dhe mundësitë që ofron. Në kontekstin e zhvillimit lokal, drejtësia gjinore shpesh kërkon marrjen e masave që kompensojnë disavantazhet historike dhe sociale që kanë prekur kryesisht gratë dhe vajzat. (UN Women, 2011)

Siç thekson edhe **Karta Evropiane për Barazi**, njësitë e vetëqeverisjes vendore janë më pranë qytetarëve dhe kanë potencialin më të madh për të ndalur riprodhimin e pabarazive dhe për të nxitur një shoqëri më të drejtë e gjithëpërfshirëse. Këto synime arrihen duke ndërthurur kompetencat e bashkisë me bashkëpunimin e ngushtë me aktorët lokalë për veprime konkrete në favor të barazisë ndërmjet grave dhe burrave, vajzave dhe djemve, të rejave dhe të rinjve. Për Bashkinë **Rrogozhinw**, nën drejtimin e Kryetarit **Edison Memolla**, integrimi i barazisë gjinore mbetet një element thelbësor i vizionit për zhvillim lokal të qëndrueshëm.

Për të adresuar më mirë sfidat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, Bashkia Rrogozinw po punon drejt forcimit të strukturave të saj sociale, duke ndjekur shembuj pozitivë të ndarjes së qartë të roleve ndërmjet **Koordinatorit Vendor kundër Dhunës në Familje** dhe **Nëpunësit të Barazisë Gjinore**. Një ndarje e tillë siguron që menaxhimi i rasteve të dhunës të jetë efektiv, ndërsa integrimi gjinor të reflektohet në të gjitha politikat dhe planet e zhvillimit të bashkisë. Kryetari **Edison Memolla** ka theksuar rëndësinë e fuqizimit të grave dhe vajzave si një parakusht për zhvillimin ekonomik dhe social të qytetit.

Megjithë përpjekjet e bëra në nivel kombëtar dhe lokal, realiteti tregon se pabarazitë gjinore dhe disavantazhet e shumëfishta ende ekzistojnë. Ato mbështeten në stereotipe të thella që hasen në familje, arsim, kulturë, tregun e punës dhe organizimin e jetës shoqërore. Pikërisht për këtë arsye, Bashkia Rrogozhinw synon që në **Planin Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2028**, të përfshijë perspektivën gjinore në të gjitha dokumentet dhe planet e zhvillimit. Ky plan do të mundësojë monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e ndërhyrjeve me **tregues të ndjeshëm gjinorë**, duke krijuar një bazë të dhënash të përditësuar sipas seksit, moshës, vendbanimit, etnisë dhe faktorëve të tjerë socialë.

Asnjë ndërhyrje vendore nuk mund të jetë plotësisht e suksesshme nëse nuk adreson nevojat specifike të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve. Prandaj, për Bashkinë Rrogozhinw, **fuqizimi i grave dhe vajzave** nuk është vetëm një objektiv social, por një investim i drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të qytetit.

• QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT

Qëllimi kryesor i këtij plani është:

Të sigurojë një qasje të integruar dhe të qëndrueshme për promovimin e barazisë gjinore në nivel vendor, duke garantuar pjesëmarrje të barabartë të grave dhe burrave në vendimmarrje, përmirësim të qasjes së grave në shërbime dhe mundësi ekonomike, si dhe mbrojtje të të drejtave të tyre.

Objektivat e Planit:

1. **Hartimi i një kuadri strategjik lokal** që përcakton prioritetet për promovimin e barazisë gjinore në Bashkinë Rrogozhinë për periudhën 2026–2028.
2. **Identifikimi i fushave prioritare të ndërhyrjes** për fuqizimin e grave dhe vajzave, duke përfshirë pjesëmarrjen në vendimmarrje, mundësitë ekonomike dhe përfshirjen sociale.
3. **Përcaktimi i objektivave specifike, treguesve dhe rezultateve të matshme** për monitorimin dhe raportimin e progresit.
4. **Sigurimi i një mekanizmi bashkëpunimi dhe koordinimi** ndërmjet bashkisë, këshillit bashkiak, institucioneve arsimore, OJF-ve dhe komunitetit.
5. **Përfshirja e masave konkrete dhe të zbatueshme**, duke marrë parasysh buxhetin e kufizuar të bashkisë dhe mundësinë e mobilizimit të mbështetjes nga partnerë dhe donatorë.

• KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Kur flasim për kuadrin ligjor dhe të politikave në fushën e barazisë gjinore, duhet të kemi parasysh që e drejta për barazi ndërmjet gjinive buron që në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 18), që është edhe dokumenti ligjor më i lartë në hierarkinë ligjore të vendit. Nën nenin 18 të kushtetutës qartësohet shprehimisht se: *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit; 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore; 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.”*. Kjo barazi de-jure është gjithashtu e shprehur edhe në një tërësi instrumentash ndërkombëtarë, të cilët kur ratifikohen nga Parlamenti shqiptar, zënë vend në hierarkinë ligjore të vendit menjëherë pas

Kushtetutës, çfarë nënkupton që nëse për një çështje të caktuar nuk ka një parashikim të qartë në legjislacionin vendas, atëherë për zgjidhjen e saj u drejtohem parashikimeve në instrumentat ndërkombëtarë të ratifikuar.

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2026 - 2028 përveçse si një instrument i zbatimit të Kartës Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore, mbështetet në një tërësi dokumentash të rëndësishëm ligjorë dhe institucionalë, të cilët udhëheqin njëkohësisht edhe veprimet mbarëkombëtare për fuqizimin e gruas dhe përparimin drejt barazisë gjinore në Shqipëri. Si më kryesoret mund të përmendim:

a) Instrumente ndërkombëtarë

- Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe burrave në jetën vendore (EU Charter for Equality).¹
- Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW).
- Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA).
- Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ).
- Strategjia e Barazisë Gjinore 2020-2025 e Bashkimit Evropian dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III) 2021-2025, etj.

b) Kuadri ligjor kombëtar

- Ligji Nr. 9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”.
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

¹ E renditur në krye të kësaj liste për shkak të rëndësisë që ka në nivelin vendor në lidhje me vetë përgatitjen e këtij PVVBGJ. Ndonëse ky dokument nuk është i ratifikuar nga shteti shqiptar, sepse nuk ka një procedurë të tillë, pjesëmarrja në të bëhet nëpërmjet nënshkrimit nga ana e vetë bashkive.

- Ligji Nr. 125/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar².
- Ligji Nr. 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.221/04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 35/2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 136/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.
- Ligji Nr.104/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 101/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.
- Ligji Nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.
- Ligji Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
- Ligji Nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 7905, datë 21.03.1995, “Kodi i Procedurës Penale”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 79/2017 “Për sportin”.
- Ligji Nr. 22/2018 “Për strehimin social”.
- Ligji Nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”.
- Ligji Nr. 75/2019 “Për rininë”, etj.

c) Politikat kombëtare

² Së bashku me Ligjin Nr. 47/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, si dhe me të gjithë ndryshimet e mëparshme që ka pësuar ligji bazë Nr. 9669/2006.

Të gjitha masat dhe veprimet e parashikuara në këtë PVVBGJ 2026 – 2028 kuptohet që mbështeten edhe në strategjitë apo planet kombëtare të veprimit që mbulojnë sektorët (drejtoritë) e caktuara sipas fushave të tyre. Por politika kryesore kombëtare mbi të cilën bazohet ky PVVBGJ është Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 -2030³.

d) Institucionet përgjegjëse

- e) Siç përshkruhet edhe në Kartën Evropiane për Barazi, përgjegjës kryesorë për zbatimin e kësaj Karte përmes përgatitjes dhe zbatimit të PVVBGJ, janë bashkitë. Në mënyrën se si është ndërtuar dhe funksionon mekanizmi kombëtar për barazinë gjinore në Shqipëri, në nivel të vetëqeverisjes vendore janë Nëpunëset/Nëpunësit e Barazisë Gjinore (NBGJ) përgjegjës për zbatimin e veprimeve në këtë drejtim, nën koordinimin e Ministrisë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Në Bashkinë Rrogozhinë, Koordinatorja Vendore kundër Dhunës në Familje kryen njëkohësisht edhe detyrat e Nëpunëses së Barazisë Gjinore (NBGJ). Me fillimin e zbatimit të këtij PVVBGJ pas miratimit në Këshillin Bashkiak, Bashkia do vijojë përpjekjet që në të ardhmen të mund të ndajë edhe pozicionin e Koordinatorës Vendore kundër Dhunës në Familje, nga pozicioni i Nëpunëses së Barazisë Gjinore, për t'i dhënë akoma më shumë përparësi integritetit të perspektivës gjinore në të gjithë fushat ku bashkia vepron.
- f) Rol të rëndësishëm në lidhje me adresimin e çështjeve gjinore, në nivelin vendor luajnë edhe Aleanca e Grave Këshilltare dhe Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqenies Sociale në nivel të Këshillit Bashkiak.
- g) Po kështu me rëndësi është edhe formalizimi i një Komisioni për Barazi Gjinore në nivel bashkie i përbërë nga Drejtore/Drejtorë të Drejtorive përgjegjëse për zbatimin e këtij PVVBGJ, duke përfshirë jo vetëm ato/ata të cilat/cilët ishin edhe pjesë e grupit të punës që përgatiti këtë plan, por edhe të drejtorive të tjera sipas nevojës. Ky Komision, do të mundësonte një zbatim akoma më të mirë të PVVBGJ-së edhe për ata elementë që nuk janë të përmendur në mënyrë të detajuar në matricë, por që siç u theksua edhe më sipër, janë të domosdoshëm për përparimin në drejtim të fuqizimit të grave, të rejave dhe vajzave dhe arritjen e barazisë gjinore (p.sh. ky Komision do të mundësonte përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjithë dokumentat zhvillimore të bashkisë, pavarësisht sektorit apo çështjes që mbulojnë). Ndaj dhe formalizimi i këtij Komisioni për Barazinë Gjinore në nivel bashkie është një ndër hapat e parë të parashikuar për zbatim, menjëherë pas miratimit të PVVBGJ në Këshillin Bashkiak. Në vijim, të gjithë institucionet vendore dhe **OJF** të cilat përfshihen si partnere për zbatimin e masave dhe veprimeve kryesore në këtë

³ Miratuar me VKM 400, datë 30.06.2021. Shiko: <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/Strategjia-Kombetare-per-Barazine-Gjinore-2021-2030.docx>

PVVBGJ, janë gjithashtu të rëndësishme dhe të domosdoshme për të pasur rezultatet e dëshiruara në përparimin drejt barazisë gjinore. Rol të rëndësishëm këtu luajnë edhe organizatat ndërkombëtare nëpërmjet mbështetjes financiare dhe teknike për të zbatuar masa të caktuara të parashikuara në këtë PVVBGJ.

METODOLOGJIA

Metodologjia e ndjekur për hartimin e **Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2026–2028 të Bashkisë Rrogozhinw** ka qenë gjithëpërfshirëse dhe e strukturuar në disa hapa kryesorë:

1. **Analiza dhe vlerësimi fillestar i situatës (desk review).**

Në këtë fazë u shqyrtuan dokumentet strategjike të Bashkisë Rrogozhinw, planet vendore ekzistuese, si dhe kuadri ligjor dhe politikat kombëtare e vendore që lidhen me barazinë gjinore. Analiza shërbeu për të identifikuar boshllëqet dhe mundësitë për integrimin e perspektivës gjinore në dokumentet e bashkisë.

2. **Identifikimi i fushave prioritare të ndërhyrjes.**

Bazuar në analizën fillestare dhe në përvojën e zbatimit të PVVBGJ-ve të mëparshme në

bashki të tjera, u përcaktuan fushat ku ndërhyrja është më e domosdoshme. Ky proces u mbështet mbi:

- vlerësimin e sfidave dhe mundësive ekzistuese në territorin e Rrogozhinws;
- përputhshmërinë me prioritetet vendore dhe kombëtare për barazinë gjinore;
- sugjerimet e marra nga konsultimet paraprake me stafin dhe partnerët lokalë.

3. Konsultime paraprake brenda bashkisë.

U zhvilluan takime me stafin e Bashkisë Rrogozhinw dhe administratorët e Njësive Administrative për:

- njohjen me Kartën Evropiane për Barazinë e Grave dhe Burrave në Jetën Vendore;
- diskutimin mbi formatin dhe përmbajtjen e PVVBGJ-së;
- mbledhjen e informacionit praktik mbi sfidat dhe mundësitë për përfshirjen gjinore në vendimmarrjen vendore.

4. Hartimi i draftit të PVVBGJ 2026–2028.

Drafti për konsultim përmbante vizionin, fushat e ndërhyrjes, objektivat specifike dhe masat konkrete për realizimin e tyre. Në këtë dokument u reflektuan sugjerimet e marra gjatë konsultimeve të para me stafin e bashkisë dhe NJA-të.

5. Konsultimi me palët dhe grupet e interesit.

Drafti i PVVBGJ-së iu prezantua:

- përfaqësuesve të njësive administrative dhe drejtorive të bashkisë;
- **organizatave të shoqërisë civile që operojnë në territorin e Rrogozhinws;**
- përfaqësuesve të biznesit lokal dhe mediave;
- **Aleancës së Grave Këshilltare dhe Këshillit Bashkiak.**

Procesi i konsultimit synoi përfshirjen e gjerë të komunitetit dhe mbledhjen e komenteve për përmirësimin e draftit. Drafti u qarkullua edhe përmes email-it dhe do të publikohet për konsultim publik në faqen zyrtare të Bashkisë Rrogozhinw përpara finalizimit.

6. Finalizimi dhe kostimi i veprimeve.

Pas integritetit të komenteve të marra gjatë konsultimeve, drafti i PVVBGJ u finalizua dhe iu shtua kostimi i masave dhe veprimeve të parashikuara.

7. Miratimi dhe publikimi.

Versioni përfundimtar i PVVBGJ 2026–2028 do të dërgohet për miratim në Këshillin Bashkiak të Bashkisë Rrogozhinw . Pas miratimit, dokumenti do të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë, ndërsa versioni anglisht do t'i përcillet Këshillit të Bashkive dhe Rajoneve të Evropës (KBRE).

• VIZIONI, FUSHAT E NDËRHYRJES DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË

Vizioni

Bashkia Rrogozhinw synon të jetë një komunitet gjithëpërfshirës ku gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë, kanë mundësi të barabarta për pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të territorit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për të gjithë qytetarët.

Fushat e Ndërhyrjes

Bazuar në analizën e situatës dhe prioritetet vendore, PVVBGJ 2026–2028 fokusohet në katër fusha kryesore të ndërhyrjes:

1. Pjesëmarrja dhe vendimmarrja e barabartë gjinore në qeverisjen vendore
2. Fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave
3. Shërbimet sociale dhe mbrojtja nga dhuna me bazë gjinore
4. Ndërgjegjësimi, edukimi dhe promovimi i barazisë gjinore në komunitet

Objektivat Specifikë për Fushat e Ndërhyrjes

1. Pjesëmarrja dhe vendimmarrja e barabartë gjinore në qeverisjen vendore

- Rritja e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes aktive të grave në strukturat e Këshillit Bashkiak dhe në proceset vendimmarrëse të bashkisë.

- Forcimi i rolit të **Aleancës së Grave Këshilltare** si mekanizëm lokal për promovimin e barazisë gjinore.
- Integrimi i perspektivës gjinore në politikat dhe dokumentet strategjike të bashkisë.

2. Fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave

- Mbështetja e grave sipërmarrëse dhe inkurajimi i iniciativave ekonomike me bazë lokale, veçanërisht në sektorët e turizmit, bujqësisë dhe artizanatit.
- Lehtësimi i qasjes së grave dhe vajzave në programe trajnimi profesional dhe kurse mbi zhvillimin e aftësive për tregun e punës.
- Promovimi i mundësive për financim dhe partneritet për bizneset e drejtuara nga gratë.

3. Shërbimet sociale dhe mbrojtja nga dhuna me bazë gjinore

- Përmirësimi i aksesit të grave dhe vajzave në shërbimet sociale dhe ato të kujdesit familjar.
- Forcimi i mekanizmave lokalë për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe për reagim të koordinuar ndërinstitutional.
- Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit për raportimin e rasteve të dhunës dhe aksesin në mbështetje ligjore dhe psikologjike.

4. Ndërgjegjësimi, edukimi dhe promovimi i barazisë gjinore në komunitet

- Organizimi i fushatave sensibilizuese dhe edukative mbi barazinë gjinore në shkolla dhe në komunitet.
- Përfshirja e burrave dhe djemve si aleatë në promovimin e barazisë gjinore.
- Promovimi i modeleve pozitive dhe historive të suksesit të grave në Rrogozhinw përmes mediave dhe aktiviteteve publike.

• AKTORËT E PËRFSHIRË NË HARTIMIN DHE ZBATIMIN E PLANIT

Hartimi dhe zbatimi i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2028 për Bashkinë Rrogozhinw është rezultat i një procesi të gjerë konsultimi dhe bashkëpunimi mes aktorëve lokalë, rajonalë dhe partnerëve të shoqërisë civile. Ky proces është ndërtuar mbi bindjen se **barazia gjinore nuk mund të arrihet pa përfshirjen aktive të të gjithë grupeve të interesit**, nga qeverisja vendore deri te komuniteti.

Në radhë të parë, **Bashkia Rrogozhinw** luan rolin qendror, si institucioni përgjegjës për planifikimin, koordinimin dhe zbatimin e masave që lidhen me barazinë gjinore. Kryetari i Bashkisë, së bashku me strukturat përkatëse, si Drejtoria e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social, Drejtoria e Financës dhe **Koordinatorja për Barazinë Gjinore**, sigurojnë që veprimet e parashikuara në plan të integrohen në politikat dhe buxhetin lokal.

Një aktor tjetër kyç është **Këshilli Bashkiak i Rrogozhinws**, i cili ka rol vendimmarrës në miratimin e politikave dhe alokimin e fondeve për masat e parashikuara. Brenda këtij këshilli, një rëndësi të veçantë ka **Aleanca e Grave Këshilltare**, e cila jo vetëm promovon fuqizimin e grave në politikë, por edhe garanton që zëri i grave dhe vajzave të përfaqësohet në çdo diskutim mbi çështjet gjinore.

Për zbatimin e suksesshëm të planit, është i domosdoshëm kontributi i **institucioneve shtetërore dhe lokale**, si Zyra e Arsimit Parauniversitare, Qendra Shëndetësore 247 dhe Zyra e Punës, të cilat ofrojnë të dhëna, ekspertizë dhe shërbime për gratë dhe vajzat, sidomos për ato që i përkasin grupeve më vulnerabël.

Gjithashtu, një rol jo më pak të rëndësishëm kanë edhe **institucionet arsimore dhe kulturore**, përfshirë shkollat, qendrat kulturore dhe bibliotekat, të cilat shërbejnë si hapësira ku promovohet edukimi, ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja e vajzave dhe grave në jetën publike e kulturore.

Spektori privat është përfshirë si partner strategjik për nisma që lidhen me punësimin dhe fuqizimin ekonomik të grave. Sipërmarrjet e vogla dhe të mesme, veçanërisht ato që operojnë në bujqësi, turizëm dhe shërbime, mund të ofrojnë mundësi punësimi dhe trajnim profesional, duke ndihmuar në rritjen e pavarësisë ekonomike të grave.

Mbi të gjitha, **komuniteti lokal** – gratë, burrat, të rinjtë, të moshuarit dhe grupet minoritare – qëndron në zemër të këtij plani. Përfshirja e tyre përmes konsultimeve publike, tryezave të diskutimit dhe aktiviteteve komunitare siguron që masat e parashikuara të pasqyrojnë nevojat dhe realitetin e përditshëm të jetës në Rrogozhinw.

Së fundi, në zbatimin e këtij plani do të mbështeten gjithashtu **partnerët dhe donatorët ndërkombëtarë**, si projekti “Bashki te Forta”, UN Women, UNDP dhe programe të Bashkimit Evropian, të cilët mund të ofrojnë asistencë teknike dhe financiare për të forcuar kapacitetet e bashkisë dhe për të garantuar që nismat për barazinë gjinore të jenë të qëndrueshme dhe efektive.

Kjo qasje gjithëpërfshirëse siguron që **plani të mos mbetet një dokument formal**, por të shndërrohet në një mjet konkret për përmirësimin e jetës së grave dhe burrave në Bashkinë Rrogozhinw, duke e bërë barazinë gjinore një realitet të prekshëm në çdo sektor të jetës shoqërore dhe ekonomike.

Fusha e Ndërhyrjes 1: Pjesëmarrja dhe vendimmarrja e barabartë gjinore në qeverisjen vendore

Objektivat Specifikë	Rezultatet e Pritshme	Treguesit
Rritja e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes aktive të grave në proceset vendimmarrëse	Gratë janë të përfaqësuara dhe marrin pjesë në vendimmarrjen vendore	- % e grave në Këshillin Bashkiak - Nr. i grave pjesëmarrëse në komisione/forume
Forcimi i rolit të Aleancës së Grave Këshilltare	Aleanca e Grave Këshilltare funksionon si mekanizëm aktiv për barazi gjinore	- Nr. i mbledhjeve dhe rekomandimeve të dhëna nga Aleanca - Nr. i iniciativave të suksesshme të ndërmarra
Integrimi i perspektivës gjinore në dokumentet strategjike	Politikat dhe planet vendore reflektojnë barazinë gjinore	- Nr. i dokumenteve strategjike që përmbajnë analizë gjinore - Nr. i rekomandimeve të integruara

Fusha e Ndërhyrjes 2: Fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave

Objektivat Specifikë	Rezultatet e Pritshme	Treguesit
Mbështetja e grave sipërmarrëse dhe inkurajimi i bizneseve lokale të drejtuara nga gratë	Rritet numri i grave të angazhuara në sipërmarrje dhe aktivitete ekonomike	- Nr. i grave të mbështetura me grante, trajnime ose kredi - % e rritjes së bizneseve të drejtuara nga gratë
Lehtësimi i qasjes në trajnime profesionale dhe punësim	Vajzat dhe gratë pajisen me aftësi për tregun e punës	- Nr. i pjesëmarrëseve në kurse/trajnime - Nr. i grave të punësuaras pas trajnimeve
Promovimi i mundësive për partneritete dhe financime	Gratë kanë akses në rrjete bashkëpunimi dhe mundësi financimi	- Nr. i marrëveshjeve ose projekteve që përfshijnë gra sipërmarrëse - Nr. i grave pjesëmarrëse në panairë/aktivitete ekonomike

Fusha e Ndërhyrjes 3: Shërbimet sociale dhe mbrojtja nga dhuna me bazë gjinore

Objektivat Specifikë	Rezultatet e Pritshme	Treguesit
Përmirësimi i aksesit në shërbimet sociale dhe të kujdesit familjar	Gratë dhe vajzat marrin shërbime cilësore sociale dhe mbështetje për kujdesin familjar	- Nr. i grave/vajzave që përfitojnë shërbime sociale - Nr. i shërbimeve të reja ose të përmirësuara
Forcimi i mekanizmave lokalë për mbrojtjen nga dhuna	Rritet reagimi i koordinuar ndaj rasteve të dhunës në familje	- Nr. i rasteve të trajtuara nga Mekanizmi i Referimit - Nr. i mbledhjeve të Mekanizmit të Referimit

Objektivat Specifikë	Rezultatet e Pritshme	Treguesit
Rritja e ndërgjegjësimit për raportimin dhe aksesin në mbështetje	Komuniteti ka informacion dhe besim për të raportuar rastet e dhunës	- Nr. i fushatave sensibilizuese dhe pjesëmarrësve - Rritja % e raportimit të rasteve

Fusha e Ndërhyrjes 4: Ndërgjegjësimi, edukimi dhe promovimi i barazisë gjinore

Objektivat Specifikë	Rezultatet e Pritshme	Treguesit
Organizimi i fushatave dhe aktiviteteve sensibilizuese	Komuniteti ka njohuri mbi barazinë gjinore dhe rolet e barabarta	- Nr. i fushatave dhe aktiviteteve - Nr. i qytetarëve pjesëmarrës
Përfshirja e burrave dhe djemve si aleatë për barazinë gjinore	Burrat dhe djemtë marrin pjesë aktive në nisma për barazi gjinore	- Nr. i burrave dhe djemve të përfshirë në aktivitete - Nr. i iniciativave që përfshijnë të dy gjinitë
Promovimi i historive të suksesit dhe modeleve pozitive	Rritet motivimi dhe frymëzimi për pjesëmarrjen e grave në zhvillim lokal	- Nr. i historive të publikuara dhe promovuara - Nr. i ndjekësve/reagimeve në mediat sociale

**• PLANI FINANCIAR I ZBATIMIT TË PVVBGJ 2026–2028 –
BASHKIA RROGOZHINW**

(Vlerësime në lekë)

Fusha e Ndërhyrjes / Aktiviteti Kryesor	2026	2027	2028	Totali (ALL)	Burimi i Financimit
1. Pjesëmarrja dhe vendimmarrja e barabartë gjinore					
Takime të Aleancës së Grave Këshilltare (4 takime/vit)	40,000	40,000	40,000	120,000	Buxhet Bashkie
Trajnime mbi integrimin gjinor për stafin dhe KK	50,000	30,000	30,000	110,000	Buxhet Bashkie + OJQ
Promovimi i pjesëmarrjes së grave në konsultime publike	20,000	20,000	20,000	60,000	OJQ/Donatorë
Nëntotal Fusha 1	110,000	90,000	90,000	290,000	
2. Fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave					
Trajnime profesionale për gra/vajza	60,000	60,000	60,000	180,000	OJQ/Programe punësimi
Promovim i bizneseve të drejtuara nga gra (panaire/ekspozita lokale)	30,000	30,000	30,000	90,000	Biznese lokale/Donatorë
Konsulenca për qasje në fonde dhe grante	20,000	20,000	20,000	60,000	OJQ/Donatorë
Nëntotal Fusha 2	110,000	110,000	110,000	330,000	
3. Shërbime sociale dhe mbrojtje nga dhuna gjinore					

Fusha e Ndërhyrjes / Aktiviteti Kryesor	2026	2027	2028	Totali (ALL)	Burimi i Financimit
Funksionimi i Mekanizmit të Referimit (mbledhje + raportim)	30,000	30,000	30,000	90,000	Buxhet Bashkie
Trajnime për identifikim dhe referim rastesh	20,000	20,000	20,000	60,000	OJQ/Donatorë
Materiale informuese dhe fushata lokale mbi dhunën	20,000	20,000	20,000	60,000	OJQ/Donatorë
Nëntotal Fusha 3	70,000	70,000	70,000	210,000	
4. Ndërgjegjësimi dhe promovimi i barazisë gjinore					
Fushata ndërgjegjësuere (8 Mars, 25 Nëntor, etj.)	20,000	20,000	20,000	60,000	Buxhet Bashkie/OJQ
Aktivitetet për përfshirjen e burrave/djemve	15,000	15,000	15,000	45,000	OJQ/Donatorë
Promovimi i historive të suksesit në rrjete sociale dhe media	10,000	10,000	10,000	30,000	Buxhet Bashkie
Nëntotal Fusha 4	45,000	45,000	45,000	135,000	

Totali i Planit Financiar (3 vite): 965,000 lekë

Me rishikimin e përvitshëm të Planit Vendor të Veprimit, ***duhet bërë patjetër edhe rishikimi i kostove të propozuara***, bazuar edhe në mënyrën e përfshirjes së tyre në buxhetet vjetore apo PBA-të e Bashkisë, si dhe në marrëveshjet me donatorët apo partnerët e mundshëm. Kjo kërkon një vëmendje të shtuar sidomos në periudhën e përgatitjes së PBA-ve dhe buxheteve vjetore, për të përfshirë në to masat dhe veprimet e parashikuara në matricën e PVVBGJ, sipas ndarjeve në vite.

• **MATRICA E PVVBGJ 2026–2028 – BASHKIA RROGOZHINW**

Fusha e Ndërhyrjes	Objektivi Specifik	Aktivitetet Kryesore	Rezultatet e Pritshme	Treguesit	Afati	Përgjegjësit	Kosto / Burime
1. Rritja e pjesëmarrjes gjinore në vendimmarrje dhe qeverisjen vendore	Të rritet përfaqësimi dhe pjesëmarrja aktive e grave dhe vajzave në proceset vendimmarrëse lokale	1. Organizim i 4 takimeve konsultative vjetore me fokus përfshirjen gjinore në politikat vendore2. Trajnime për gratë këshilltare mbi lidershipin dhe rolin e tyre në mbrojtjen e të drejtave të grave3. Krijimi i një regjistri të grave aktive në komunitet për t'u përfshirë në konsultimet vendore	- Gratë dhe vajzat marrin pjesë më shumë në vendimmarrje- Rritet kapaciteti i grave në këshillin bashkiak për të ndikuar në politika	- % e grave që marrin pjesë në takime- Nr. i grave të trajnuara- Regjistri i grave i përditësuar	2026–2028	Bashkia / Aleanca e Grave Këshilltare / OJF lokale	50,000 ALL (për trajnime & logjistikë)

Fusha e Ndërhyrjes	Objektivi Specifik	Aktivitetet Kryesore	Rezultatet e Pritshme	Treguesit	Afati	Përgjegjësit	Kosto / Burime
2. Fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave	Rritja e mundësive për vetëpunësim dhe të ardhura për gratë në zonat urbane dhe rurale	1. Trajnime mbi sipërmarrjen, marketingun e produkteve bujqësore dhe artizanale (1 trajnim çdo vit)2. Krijimi i një këndi promovimi në panairot lokale për produktet e grave3. Ngritja e një rrjeti të grave sipërmarrëse lokale për mbështetje dhe bashkëpunim	- Gratë përmirësojnë aftësitë për të menaxhuar biznese të vogla- Produkte lokale promovohen si pjesë e identitetit të zonës	- Nr. i grave të trajnuara (min. 30)- Nr. i bizneseve të grave të promovuara- Nr. i aktiviteteve ekonomike ku marrin pjesë gratë	2026–2028	Bashkia / Drejtoria e Bujqësisë / OJF mbështetëse	80,000 ALL (trajnim, promovim & logjistikë)

Fusha e Ndërhyrjes	Objektivi Specifik	Aktivitetet Kryesore	Rezultatet e Pritshme	Treguesit	Afati	Përgjegjësit	Kosto / Burime
3. Parandalimi i dhunës me bazë gjinore dhe forcimi i mbrojtjes sociale	Funksionalizimi i mekanizmave lokalë të referimit dhe rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit për dhunën me bazë gjinore	1. Aktivizimi dhe trajnimi i Mekanizmit Vendor të Referimit për dhunën në familje (2 herë në vit)2. Fushata ndërgjegjësimi në shkolla, qendra komunitare dhe rrjete sociale 3. Shpërndarje e materialeve informuese mbi të drejtat e grave dhe shërbimet sociale	- Rritet raportimi i rasteve të dhunës dhe ndërhyrja e shpejtë- Komuniteti është më i vetëdijshëm për mbrojtjen sociale	- Nr. i mbledhjeve të Mekanizmit të Referimit- Nr. i rasteve të referuara dhe trajtuara- Nr. i aktiviteteve ndërgjegjëse dhe pjesëmarrësve	2026–2028	Bashkia / DRSHSSH / Policia / OJF të licencuara	60,000 ALL (materiale & aktivitete ndërgjegjësimi)

Fusha e Ndërhyrjes	Objektivi Specifik	Aktivitetet Kryesore	Rezultatet e Pritshme	Treguesit	Afati	Përgjegjësit	Kosto / Burime
4. Ndërgjegjësimi publik dhe edukimi për barazinë gjinore	Edukimi i komunitetit për barazinë gjinore dhe ulja e stereotipeve gjinore	1. Organizim i 2 ditëve informuese çdo vit mbi barazinë gjinore2. Aktivitet kulturor dhe sportiv për promovimin e barazisë gjinore3. Publikim i postimeve dhe videove sensibilizuese në faqen zyrtare të bashkisë dhe rrjete sociale	- Komuniteti është më i informuar mbi barazinë gjinore- Rritet mbështetja e qytetarëve për rolin e grave në shoqëri	- Nr. i aktiviteteve të realizuara- Nr. i pjesëmarrësve- Nr. i postimeve dhe shikimeve online	2026–2028	Bashkia / Qendra Kulturore / Shkollat / OJF rinore	40,000 ALL (postera, video & aktivitete)

• PLANI I MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT PËR ZBATIMIN E PVVBGJ

1. Qëllimi i Planit të Monitorimit dhe Vlerësimit

- Sigurimi i një procesi të vazhdueshëm dhe sistematik për mbledhjen dhe analizën e të dhënave për zbatimin e PVVBGJ.
- Vlerësimi i performancës në arritjen e objektivave dhe rezultateve të planit.
- Identifikimi i sfidave dhe rekomandimet për përmirësime.
- Rritja e transparencës dhe llogaridhënies ndaj komunitetit dhe palëve të interesuara.

2. Elementet Kryesore të Monitorimit

Çfarë do të Monitorohet?	Si do të Matet? (Treguesit)	Burimi i të Dhënave	Frekuenca e Monitorimit	Personi/Aktorët përgjegjës
Zbatimi i masave dhe aktiviteteve të PVVBGJ	Numri i aktiviteteve të realizuara sipas planit, përqindja e zbatimit	Raportet periodike të zbatuesve, procesverbalet, raportet e trajtimeve	Çdo 6 muaj	Koordinatorja për Barazinë Gjinore, Bashkia, KBRE
Pjesëmarrja gjinore në strukturat vendimmarrëse	Përqindja e grave në këshill dhe komisione, numri i grave të trajnuara	Regjistrat zyrtarë, listat e pjesëmarrësve në trajnim	Vjetor	Bashkia, KBRE
Buxhetimi gjinor dhe integrimi i perspektivë gjinore	Raporti i përgatitur për buxhetimin gjinor	Dokumente buxhetore, raporte financiare	Vjetor	Drejtorja e Financës, Koordinatori për Barazinë Gjinore

Çfarë do të Monitorohet?	Si do të Matet? (Treguesit)	Burimi i të Dhënave	Frekuenca e Monitorimit	Personi/Aktorët përgjegjës
Funksionaliteti i mekanizmit të referimit për dhunën	Numri i rasteve të trajtuara, takimet e mekanizmit	Raportet e mekanizmit vendor të referimit	Çdo 3 muaj	Bashkia, Policia, Qendra Sociale
Ndërgjegjësimi i komunitetit për barazinë gjinore dhe dhunën me bazë gjinore	Numri i fushatave, pjesëmarrës në fushata, nivel vëmendjeje/sensibilizimi	Raporte fushatash, sondazhe opinionit (opsionale)	Vjetor	Bashkia, Shoqëri Civile, Media

3. Metodat e Mbledhjes së të Dhënave

- **Raporte periodike:** Zbatuesit e masave (bashkia, partnerët) dorëzojnë raporte të detajuara për aktivitetet e zhvilluara dhe rezultatet.
- **Intervista dhe pyetësorë:** Për të matur perceptimin e komunitetit dhe pjesëmarrësve në trajnime dhe fushata.
- **Mbledhje të dhënash statistikore:** Nga regjistrat zyrtarë të bashkisë dhe mekanizmave përkatës.
- **Takime të rregullta të mekanizmit të monitorimit:** Për të shqyrtuar avancimin dhe sfidat.

4. Faza e Vlerësimit

Faza	Përshkrimi	Koha e Zbatimit	Personi/Aktorët përgjegjës
Vlerësimi fillestar (Baseline)	Mbledhja e të dhënave fillestare për treguesit kryesorë para nisjes së zbatimit.	Para fillimit të planit (2026)	Koordinatori për Barazinë Gjinore, Bashkia
Monitorim i vazhdueshëm	Mbledhja dhe analiza periodike e të dhënave sipas planit të monitorimit.	Gjatë gjithë periudhës së zbatimit (2026–2028)	Koordinatori, KBRE, Partnerët
Vlerësimi mid-term (në mes të periudhës)	Analizë e avancimit, identifikim i sfidave, rishikim i masave nëse është e nevojshme.	Në mes të periudhës së zbatimit (2027)	Bashkia, Ekspert i jashtëm (opsional)
Vlerësimi final	Vlerësim i përgjithshëm i arritjeve të planit, mësimet nxjerra dhe rekomandime për periudhën tjetër.	Pas përfundimit të planit (2028)	Bashkia, Ekspert i jashtëm, KBRE

5. Raportimi dhe Përdorimi i Rezultateve

- **Raportet e monitorimit** do të publikohen në faqen zyrtare të bashkisë dhe do të shpërndahen tek palët e interesuara (shoqëri civile, partnerë, komunitet).
- **Takimet vjetore me komunitetin dhe palët e interesuara** për të diskutuar avancimin dhe sfidat.
- Përdorimi i rezultateve për përmirësimin e vazhdueshëm të planit dhe përcaktimin e prioriteteve të reja.

• PËRFUNDIME

1. Rritja e ndërgjegjësimit dhe përkushtimit institucional

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) paraqet një hap të rëndësishëm drejt avancimit të barazisë gjinore në Bashkinë Rrogozhinw. Përkushtimi institucional dhe pjesëmarrja e aktorëve kyç janë themeli i një procesi të suksesshëm për përmirësimin e barazisë gjinore dhe integrimin e saj në politikat lokale.

2. Buxhetimi dhe angazhimi financiar

Edhe pse buxheti është minimalist, përfshirja e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor është një arritje e rëndësishme. Kjo tregon dëshirën dhe mundësinë për të adresuar nevojat gjinore në mënyrë të qëndrueshme.

3. Përmirësimi i mekanizmave për mbrojtjen nga dhuna

Theksi në ngritjen dhe funksionalizimin e mekanizmave vendorë për referim dhe trajtim të rasteve të dhunës me bazë gjinore është i domosdoshëm për garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes së viktimave.

4. Pjesëmarrja aktive e komunitetit

Fushatat ndërgjegjëse dhe përfshirja e shoqërisë civile janë hapa të domosdoshëm për ndryshime kulturore dhe sociale që ndikojnë drejtpërdrejt në zbutjen e pabarazive gjinore dhe diskriminimit.

5. Nevoja për monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm

Procesi i monitorimit dhe vlerësimit është thelbësor për të matur avancimin, për të identifikuar sfidat dhe për të garantuar që masat e parashikuara të jenë efektive dhe të qëndrueshme në kohë.

• REKOMANDIME

1. Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe njerëzore

Rekomandohet zhvillimi i trajnimeve të vazhdueshme për staf dhe zyrtarë lokalë mbi barazinë gjinore, buxhetimin gjinor dhe trajtimin e dhunës në familje.

2. Sigurimi i burimeve të qëndrueshme financiare

Bashkia duhet të punojë për të siguruar fonde shtesë, përfshirë nga donatorë dhe partnerë ndërkombëtarë, për të mbështetur masat e planit, duke përfshirë fushatat dhe funksionimin e mekanizmave të referimit.

3. Rritja e bashkëpunimit ndërinstytucional

Forcimi i bashkëpunimit mes bashkisë, institucioneve të drejtësisë, policisë, shërbimeve sociale dhe organizatave të shoqërisë civile për një trajtim më efikas të çështjeve gjinore.

4. Angazhimi i komunitetit dhe promovimi i ndryshimeve kulturore

Zhvillimi i më shumë fushatave sensibilizuese dhe aktiviteteve me komunitetin për të ndryshuar mentalitetet dhe për të luftuar stereotipat gjinorë që ndikojnë në pabarazitë dhe dhunën.

5. Përmirësimi i mekanizmave të monitorimit

Sugjerohet krijimi i një sistemi të thjeshtë, por të efektshëm të monitorimit dhe raportimit që përfshin indikatorë të matshëm dhe të kuptueshëm për të gjitha palët e përfshira.

6. Përditësimi dhe rishikimi periodik i planit

Rekomandohet që plani të rishikohet dhe përditësohet në bazë të rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit, për t'u përshtatur me realitetin dhe nevojat e reja të komunitetit dhe bashkisë.